

LIGJ
Nr. 13/2018

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS
“BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT
MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 104/2015,
NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE
SHOQËRISË KONCESIONARE “PORTI MBM (*MULTY BUOY MOORING*)”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10750, datë 3.4.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

SHITESË E KONTRATËS
SË KONCESIONIT

**TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË
LLOJIT MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS, NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE
“PORTI MBM (*MULTY BUOY MOORING*)”**

Kjo shtesë e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, është nënshkruar në datë 12.12.2017, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me adresë në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si “Autoriteti kontraktues”), përfaqësuar nga z. Damian Gjoknuri, ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, përfaqësuar nga z. Mirgen Nikaj, administrator i shoqërisë (këtu e më poshtë referuar si “Koncesionari”);

Meqenëse:

A. Ndërmjet ish-Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, më datë 21.7.2015, është firmosur një kontratë koncesioni e formës “BOT”, e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 104/2015, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”;

B. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM-së nr. 504, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, është ministria përgjegjëse për shfrytëzimin e porteve dhe Autoritet kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor;

C. Shoqëria Porti MBM ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndryshimin e kontratës koncesionare, që ka si qëllim garantimin e funksionimit të linjës principiale teknologjike të paraqitur në kontratën fillestare, nga kushtet e paparashikuara teknike;

Ç. Palët njohin dhe pranojnë faktin që ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve të tjera thelbësore të kontratës koncesionare; si dhe

D. Ministria e Infrastrukturës gjen të argumentuar kërkesën e shoqërisë, që kërkon ndryshimin e elementeve të veçanta të strukturës së objekteve të përfshira në këtë projekt, për shkak të ndryshimeve të situatës reale në terren;

Bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Pika 1 e nenit 16 ndryshohet si më poshtë:

16.1 Vlera që koncesionari do të investojë në këtë koncesion është 14.500.000 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind mijë) dollarë, si më poshtë:

- i) Studim dhe zhvillim paraprak me vlerë prej 153,000 USD;
- ii) Faza përgatitore e terrenit me vlerë prej 6,903,000 USD;
- iii) Faza ndërtim/zhvillim (materiale dhe pajisje; mjete dhe makineri; kosto pune) me vlerë prej 7,138,000 USD;
- iv) Faza ndërtim/zhvillim me vlerë prej 306,000 USD.

Neni 2

Aneksi 1 i kontratës koncesionare zëvendësohet me aneksin 1/1 bashkëlidhur kësaj shtese kontrate.

Neni 3

Tabela e detajimit të investimit të përcaktuar në aneksin 3 të Kontratës zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur kësaj shtese kontrate.

Neni 4

Koncesionari dhe shoqëria koncesionare gjatë ndërtimit dhe operimit të koncesionit do zbatojnë legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe atë mjedisor, si dhe çdo detyrim dhe angazhim tjetër të marrë përsipër në kontratën koncesionare.

Neni 5

Kjo kontratë është nënshkruar në tri kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë. Kjo kontratë, pasi të nënshkruhet nga Palët, hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit që do ta miratojë.

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Damian Gjikhuri

Për shoqërinë Porti MBM

Z. Mirgen Nikaj

**SHTESE PER PORTIN E HAPUR MBM
PORTO ROMANO - D U R R E S -**


PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA



POZICIONI GJEOGRAFIK - "Porti MBM", Porto-Romano, Durrës

Dhënie me koncesion për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM (*Multi Buoy Mooring*), në Porto-Romano, Durrës.

Zona e individualizuar për ndërtimin e fushës së bovave MBM ndodhet në afërsi të bregdetit shqiptar mbi 2,500 m nga linja bregdetare në afërsi të Porto-Romanos, Durrës, brenda koordinatave.



Pjesa e dytë është pjesa e impiantit në distributorin shpërndarës. Distributori shpërndarës shërben për lidhjen e operatorëve të ndryshëm që duan të shfrytëzojnë sistemin e ankorimit të llojit MBM ndodhet në koordinatat:

Pika "P1" N- 41°22'32.520";
E- 19°25'19.200".

Për të kryer operacionet në tokë duhet një sipërfaqe toke prej 3,850 m². Kjo sipërfaqe është paralel me rrugën ekzistuese për në Romano-Porto me distancë 12 ml nga aksi i saj, për të mos penguar edhe zgjerimin në perspektivë të kësaj pjese të rrugës. Sipërfaqja e nevojshme është në formë paralelogrami (me gjatësi mesatare) ml dhe gjerësi 50 ml dhe me sipërfaqe 3,850 m². Brenda këtij sheshi duhet të ndërtohet një godinë, e cila do të shërbejë si stacion pompimi, zyra të nevojshme, si edhe ambiente të tjera të nevojshme për operimin.

Pjesa e tretë është e ndarë në tre sektorë:

a- Sektori i argjinaturës mbajtëse të tubave me shtrirje nga vija e intercektimit të tokës me detin me gjatësi 770 ml, në det, me profil gjatësor nga +/-0.00 deri në thellësinë -10.00 me gjerësi të pjesës së sipërme të argjinaturës 10 ml.

b- Sektori i shtrirjes së tubave nga argjinatura në taban të detit me gjatësi mbi 1730 ml deri në sektorin e bovave të lidhura me Plemën.

Tubacionet për sektorin a dhe b do të jenë tri me diametër 323.9 mm, ky i fundit i pajisur me kundërtub për kontrollin e temperaturës, të tre tubat janë të mbrojtur me shtresë gome dhe të veshur me beton me trashësi 2 cm, për ruajtjen nga goditjet mekanike të mundshme.

c- Në anën jugore të kësaj argjinature aneksohet një aneks vertikal me të me gjatësi 55 ml për ankorimet e mjeteve të vogla që do të shërbejnë gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit. Ky aneks është i vendosur 400 ml nga vija e ujit.

PLANI NE RAJON I SHITESSES SE PORTIT TE HAPUR MBM PORTO ROMANO - D U R R E S -




Shenime :

--- LINJA QE SPOSTOHET PARALEL ME 40mI.

PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

PLANI I STRUKTURES SHITES PORTI I HAPUR MEM
PORTO ROMANO - DURRES -
ARGJINATURA DHE SPOSTIMI I DY TUBOVE



PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

SHENIME :
- LINJA SPOSTIMET NE 40m, PARALEL ME LINJEN E NIVELIUT.


PROFILI GJATESORE I ARGJINATURES PER TUBAT PARALEL ME ROMANO PORTON




PROFILI GJATESORE I ARGJINATURES PER PER RUAJTJEN E TUBAVE



PROFILI TERTHORE PARELEL ME ROMANO PORTON



PROFILI TERTHORE NE DALLGE KTHYESIN JUGORE




PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA



PROFILI TIP
I TUBAVE NE TABAN TE DETIT



- PROFILI TIP I ARGJINATURES ESITE 2.5mI, MBI NIVELIN E DETIT DHE NEN NIVELIN E DETIT VARJON NGA +/-00 DERI NE -10.00mI.




PROJEKTO I
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

DETAI PLANIMETRIK




BAZAMENT ANKORIMI B/A
2*2+2m PER ANKORIMIN E
INJETIVE LUNDRESE

**MURE MBAJTES BLOOE
ME BUTO BETON**




BLLOK BUTO BETONI
PER MUR IN MBAJTES




PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

- IMPUNȚI * PORT * HAPUR BOM * PER FAZEN E NORTIN SHERTZINIT KA TE NEVOSHME NORTIN E NJE MINI VENO, PER ANORININ E NJETJE TE VOGLA LUNDRIESE.
- ESITE MENDUAR TE NORTOCHET NJE MINI DALLGE KTHYES DE NGA ANA E ANORINIT TE NJETJE TE RIQMET ME MURE BUTO BETONI SI NE PROJEKT, ME BLOODE 200-200+250CM.
- NE ARGJINTURE JANE MENDUAR ESHE DISA BAZAMENTE ANORINI ME DIMENSIONE 200-200+200CM, TE ANIHARA.


PLANIMETRIA ARGJINATURA NE ANEN JUGORE RRUGA PER REALIZIM



PROFILI TERTHORE NE DALLGE KTHYESIN JUGORE




PROFILI GJATESORE I ARGJINATURES PER PER RUAJTJEN E TUBAVE



RRUGE PER MBUSHJEN E DALLGE
THYESIT NE KUOTEN +2.00.
ME GJATESI 672m I.

RRUGE PER MBUSHJEN E DALLGE
THYESIT NE KUOTEN +2.00.
ME GJATESI 672m I.



Technical drawing of a sewerage system profile and plan view.

Profile View (Top):

- Left side: T.M.H. | BANCHEMENT | 112.4'
- Right side: T.M.H. | BANCHEMENT | 111.5'
- Center: PROFIL | BANCHEMENT 1%
- Bottom: 112.4' | 111.5'

Plan View (Bottom):


- Left side: T.M.H. | BANCHEMENT | 112.4'
- Right side: T.M.H. | BANCHEMENT | 111.5'
- Center: PROFIL | BANCHEMENT 1%
- Bottom: 112.4' | 111.5'

DETAIL I ZBRITJES SE TUBOVE NE DETE

PROJEKTO I
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA


- LINJAT E KARBURANTIT NE TOKË DHE NE ARGJINJURE VENDOSËN
 MBI BAZAMENTË B/A QO 12m².
 - KIJDESH DUHET TE REALIZOHET PER ULJEN E SKARPAES NGA
 ARGJINJURA NE TABANIN E DETIT ME DIFERENCE 12.5m². DHE VENDOSJA
 E KUNDRA, PESHAVE PER RUATJEN DHE FIKSIMIN E TUBAVE.
 - NE PËSEJEN E ARGJINJURES REALIZIMIN E DHE TUB MBROTES BEN
 TE MINJOR GARANCIN DHE REALIZIMIN TEKNIKISTIT TE LINJES.

LINJA TEKNOLOGJIKE E NDRYSHUAR




PLEMI


SHEJTI :
ESITE NE PAISJE
SPECIALE MANORIMI
DHE SINALISTIKE.
ESITE NE GRUP
VALORASH AUTOMOTIVE
DHE GRANISHA E GJITHJE
IMPJANTIT.
PAISJA ESITE POROSITUR
NE FIRMAT NE PRESTIGJITZE
TE KESAJ FUSE.




PROFILI TIP I TUBAVE NE TABAN TE DETIT




PROFILI MBI ARGJINATURE



DETAL I HARKUT




DETAL NE SHKARPAT



PROJEKTOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

SHEJTI :
- DY LINJAT E TUBAVE NE 0.323.9+12.7m, TE IZOLUARA NE PLASTINE JASHT ERDE BREDA SI DHE NE ANEN E JASHTERE KAN VESHJE BETONI ME TRASHESI 20cm.
- LINJAT NE TOKE DHE NE ARGJINATURE JANE TE FIKSUARA MBI BAZIMENTE B/A, ME DIMENSIOME 50+100+300cm, CDO 12m, TE FIKSUARA ME KAVALLOTA HEKURI
TE VESHURA NE GOMIA PER TE ELIMINUAR FERKIMIN NE BETONIN MBROJTES TE TUBAVE.
- E RENDISIME ESITE TE THESHMET PUES KALUESE NGA ARGJINATURA E TUBIT NE DREJTIMIN TE TABANIT TE DETIT NE DIFERENCA KUOTE 12.5m, KETU TUBAT
KANE NEVOJE TE MBROHEN NGA NIVE TUBE TJETRE NE 0.50cm. KJO PER DY ARSYE, E PARA PER BELLINE TERKIME TE REALIZIMIT TE DIFERENCATE TE KUOTIVE DHE
E DYTIA, TUBAT NE KETE PASE JANE TE ZBULUARA NGA GODITJET E DALLGJEVE TE MEDHA DE MUNDET TA SPOSTOJNE E TA SHKATERRONE LINJEN DHE MBI KETE
TUBA VENDOSEN KUNDRA PESA B/A ME FORME SA ME TE PERSHTATESHME PER ELIMINIMIN E FORCAVE DETARE.
- PESA E TUBAVE NGA FUNDI I ARGJINATURES DERI TER PLEMI, SHTRIMET NE SUPERFACI TE FUNDI TE DETIT NE GJENDJE TE LIRE, PASI TE JEN
BERE PROVAT E NGARCES NE TERREN PER KETE QELLIM.
- PLEMI ESITE NIE AGREGAT SHUME I RENDISISHEN I MANORIMIT KRYESISHT AUTOMOTIK DHE I SINALISTIKES.

PLANI I STRUKTURES SHITESE PORTI I HAPUR MBM
PORTO ROMANO - DURRES -
TRASHEJA E TUBACIONEVE PER NDRICIMIN DHE KAMERAT



PROJETOI
ARK. ILIR TAGA
ING. KRISTO GOGA

SHENIME :

- TUBACIONET E BRINJEUARA PER NDRICIM DHE KAMERAVE JANE NEN TUKESORE DHE ME Ø 200mm.
- PUSETAT E KONTROLLIT 80-80 ME THELLESË 100cm, ME KAPAKE HEHMETIK.
- PER ÇDO PUSETE KONTROLLI VENOSJET NJE NDRICIM ME ARTESI 8m, PA PËRJASHTUAR EDHE NDRICIMIN ME PANEL DIELLORE.
- NE NDRICUAT, SI PAS KËRKESAVE TEKNOLOGJIKE DHE TE SIGURISE VENOSHEN KAMERA.
- BAZAMENTET PER ÇDO NDRICIM JANE BIA 50-50 ME THELLESË 100cm.

INVESTIMI I PËRGJITHSHËM

Investimi për zbatimin e këtij projekti arrin vlerën 14.5 milion USD.

Detajim i investimit te vlerësuar është si me poshtë:

NR	PERSHKRIMI	VLERA (USD)
1	Studim dhe Zhvillim Paraprak	\$153,000
	Analize teknike dhe ekspertize inxhinierike	\$47,800
	Analize dhe projektim financiar te projektit	\$41,000
	Analize mjedisore	\$20,800
	Studim fizibiliteti dhe zhvillimi	\$35,800
	Te tjera	\$7,600
2	Faza Pergatitore e Terrenit	\$6,903,000
	Rregullim pershtatje terreni	\$2,070,900
	Germime dhe punime ne terren	\$3,796,650
	Kosto pune dhe materiale	\$690,300
	Te tjera	\$345,150
3	Faza Ndertim / Zhvillim	\$7,138,000
	Materiale dhe pajisje	\$5,351,600
	Struktura betoni/bloqe "sinkers"	\$134,000
	Konduktore (tubacione sea-line)	\$375,200
	Bova dhe elemente	\$696,600
	Serbatore	\$187,600
	Spirancat ((bash/ankorim/spirance roje)	\$482,300
	Zinxhire dhe elemente lidhes (pendent/sniker)	\$321,500
	Valvulat PLEM	\$1,071,800
	Disqe dhe pajisje te tjera	\$964,600
	Pajisje sigurie (zjarrfikese/emergjence)	\$850,000
	Te tjera	\$268,000
	Mjete dhe Makineri	\$714,600
	Mjete pluskuese (anije ancorimi/rimorkiator)	\$142,800
	Sistem sinjalizimi detar	\$178,500
	Sistemi I ancorimit te bovave	\$214,500
	Automjete	\$143,000
	Te tjera	\$35,800
	Kosto pune per montim/ndertim/zhvillim	\$1,071,800
4	Faza Ndertim / Zhvillim	\$306,000
	Shpenzime trajnimi dhe drejtimi	\$306,000
	TOTAL	\$14,500,000